



BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhe, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sherbimi i printimit dhe fotokopjimit”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,968,000 (kater milion e nentëqind e gjashtedhjetë e tete mijë) lekë pa TVSH.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë e kriterëve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta te kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përrashkohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Një dokument që vërteton se subjekti ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Sa me siper, Autoriteti Kontraktor mban ne konsiderate se operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likjuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashmë janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqese vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashmë janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të kete të punësuar mesatarisht të paktën 2 (dy) punonjës për periudhën Janar 2026 – Mars 2026.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë: Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhen e kërkuar, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është një prove bindese për AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoje te punesuar si me poshte:

a) -te pakten 1 punonjes, te paisur me diplome inxhinier (IT/inxhinier elektronik) i cili gjithashtu duhet te jete i çertifikuar edhe për mirembajtjen e pajisjeve RICOH ose ekuivalente, (Certifikata e trajnimit duhet te jete e leshuar nga prodhuesi i markes RICOH ose ekuivalente).

Në rastin e certifikatave ekuivalente këto duhet të jenë të lëshuara nga distributor te autorizuar të cilët kanë të drejtë për të trajnuar specialist për mirëmbajtjen e pajisjeve RICOH)

b) -te pakten 1 punonjes, te paisur me diplome inxhinier (IT/inxhinier elektronik) i cili gjithashtu duhet te jete i çertifikuar edhe për mirembajtjen e pajisjeve XEROX ose ekuivalente, (Certifikata e trajnimit duhet te jete e leshuar nga prodhuesi i markes XEROX ose ekuivalente).

Në rastin e certifikatave ekuivalente këto duhet të jenë të lëshuara nga distributor te autorizuar të cilët kanë të drejtë për të trajnuar specialist për mirëmbajtjen e pajisjeve XEROX)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperme: Kontraten individuale te punës, Diplomen Universitare, Certifikaten e trajnimit (te leshuar nga prodhuesi i markes RICOH dhe XEROX ose ekuivalente) si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Janar 2026 – Mars 2026.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat dhe certifikatat) qe nuk jane leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

Per punonjesin e sipercituar, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesit ne diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i diplomes Universitare	Numri indetifikues i certefikates se trajnimit	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1						

2						
.....						

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cila duhet te dorezohet ne fazën e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates dhe Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Prania e stafit per afatin e kerkuar ne listepagesa i verteton AK se operatori ekonomik ka nje staf te qendrueshem, operativ i cili do te kryeje sherbimin ne kohe dhe cilesi.

Gjithashtu, në lidhje me disponueshmërinë e punonjesit të kualifikuar, ky kriter eshte vendosur se duke marrë në konsideratë natyrën dhe kohëzgjatjen e shërbimit, shtrirjen e tij në territor (ofrimin e shërbimit në Bashkinë Lezhë dhe në zyrat e njërive administrative, si edhe numri i lartë i pasjeve për të cilat do të ofrohet shërbimi shfaqet e nevojshme qe OE te kete te punësuar punonjesit e kerkuar nga AK, me nivel kualifikimi inxhinier të profileve të ndryshme te cilet duhet te jene te certifikuar nga prodhuesi apo distributor i autorizuar qe do të kryejne shërbimin e mirëmbajtjes se pajisjeve te printim/fotokopjimit.

Kerkesa per nje punonjes te certifikuar është një kerkese proporcionale për kryejren e shërbimit duke marrë në konsideratë faktin se ky shërbim do të kryhet minimalisht per paisjet e kerkuar ne termat references i cili eshte i nevojshëm për kryerjen e shërbimit për paisjet në Bashkinë Lezhë, si dhe sipas nevojës në 9 Njësitë Administrative.

Ndersa ne lidhje me kualifikimin e punonjesit të mësipërm krahas nivelit të kualifikimit inxhinier IT/elektrik/inxhinier elektronik (e lënë e hapur duke mos shfaqur diskriminim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë) duhet të disponojnë edhe dëshmi kualifikimi certifikuar për mirembajtjen e pajisjeve për markat e pajisjeve qe disponon AK ose ekuivalente.

Duke qenë se ekspertët mund të disponojnë dëshmi kualifikimi ekuivalente eshte kerkuar qe ne kete rast këto dëshmi duhet të jenë të lëshuara nga distributor te autorizuar të cilët kanë të drejtë për të trajnuar specialist për mirëmbajtjen e pajisjeve qe disponohen nga AK.

Po ashtu Njësia e Prokurimit konstaton se në temrat e referencës së procedurës së prokurimit ndër të tjera parashikohet se: “Shërbimi i mirëmbajtjes konsiston në ofrimin e të gjitha pjesëve konsumuese të

fotokopjes (zhvillues, cilindër, gomina etj) dhe të mirëmbajtjes nga ana teknike të pajisjes dhe operatori ekonomik paguhet në bazë të faqeve të printuara/fotokopjuara nga pajisjet”.

Ofrimi i shërbimit të printimit luan një rol kyç për mbarëvajtjen e punës të institucionit të Bashkisë Lezhë, për këtë arsye edhe në termat e referencës është kërkuar ndër të tjera që: *“Fotokopjet janë të lidhura në rrjet dhe përdoren nga të gjithë punonjësit e administratës. Per shkak të volumit të punes pajisjet do të funksionojnë 24 orë pa ndërprerje dhe do të jenë të kompletuar me tonerë dhe pjesët konsumuese”.*

Për këtë arsye disponueshëmeria e kërkesave të mësipërme jena në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit si edhe i përgjigjet testit të proporcionalitetit duke përmbushur synimin e kërkuar (garantimin e ofrimit të shërbimit në përputhje me termat e referencës, **kryerjen e shërbimit nga operatorë të kualifikuar e cila lidhet drejtpërdrejtë edhe me jetëgjatësinë e paisjeve në pronësi të autoritetit kontraktor**).

Per me teper NjP gjykon se për tu provuar përmbushja e kriterit të mësipërm për certifikimin e stafit, është lënë e hapur, që të jenë të certifikuar si nga prodhuesi ashtu edhe nga distributori i autorizuar, me kusht që ky i fundit të provojë lidhjen me prodhuesin me dokumentacion provues, **pasi mirembajtja e pajisjeve lidhet drejtpërdrejtë edhe me jetëgjatësinë e paisjeve në pronësi të autoritetit kontraktor**.

Autoriteti Kontraktor ka detyrimin që të sigurojë shërbimin e mirembajtjes nga profesionist të certifikuar nga prodhuesi apo subjekte të autorizuar nga ana e tij pasi nuk mund të marrë persiper riskun që pajisjet të demtohen gjatë riparimit.

2.3.4 Operatori ekonomik për pjesët konsumuese (zhvillues, cilindër, gomina) të fotokopjes dhe printerave, në rast se nuk është prodhues ose distributor zyrtar për territorin e Republikës së Shqipërisë i markes **RICOH** dhe markes **XEROX** duhet të jetë i pajisur me autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar për territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar për territorin e Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast operatori ekonomik duhet të deklarojë adresat, nr. tel, email, emër mbiemër të personave të kontaktit në kompaninë prodhuese për verifikimin e dokumentacionit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 1, 2 dhe 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se **mirembajtja teknike e pajisjeve në pronësi të AK do të bëhet me pjesë kembimi origjinale** të autorizuar nga prodhuesi apo distributori zyrtar, pasi lidhet drejtpërdrejtë me jetëgjatësinë e paisjeve në pronësi të autoritetit kontraktor.

Njesia e Prokurimit argumenton se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi për kryerjen e shërbimit është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë origjinalitetin e produkteve që perdoren për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes. Për rrjedhojë AK mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave (pjesëve të kembimit) që perdoren në kuadrin e mirëmbajtjes së pajisjeve, të lëshuara direkt nga prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi. Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokurimit Nj.P vlerëson se autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi dokumenti i kërkuar mund të sigurohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre shërbimin e kërkuar dhe për të cilat kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e pjesëve që perdoren gjatë mirëmbajtjes së pajisjeve. Me kriterin e vendosur autoriteti kontraktor nuk ka tejkaluar objektin e prokurimit pasi për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet që shërbimi i mirëmbajtjes të kryhet sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës duke qenë se ky shërbim lidhet drejtpërdrejtë edhe me jetëgjatësinë e paisjeve në pronësi të autoritetit kontraktor.

Njesia e Prokurimit thekson se për rëndësinë dhe qëllimin e vendosjes së këtij kriteri ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe **Komisioni i Prokurimit Publik** në vendimin nr. 114/2021 për një procedurë prokurimi të ngjashme të llojit shërbime ku ndër të tjera citon se *“Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, gjykojmë se, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi”*.

Për sa me lart, theksojmë se Autoriteti Kontraktor ka detyrimin që të sigurojë shërbimin e mirëmbajtjes nga profesionist të certifikuar nga prodhuesi apo subjekte të autorizuar nga ana e tij pasi nuk mund të marrë për riskun që pajisjet të demtohen gjatë riparimit.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi një automjet.

Për kete duhet të paraqesë:

- Ne rast te disponimit te automjetit ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: çertifikaten e pronesise; leja e qarkullimit; çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore.
- Ndersa per mjete te marra me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase/ bashkëpunimit.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar sherbimit sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së kontrates. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet sipas specifikave.

2.3.6 Operatorët Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- **ISO 9001: 2015** “Per Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalentin e saj
- **ISO 20000: 2018** “Për sistemin e menaxhimit të shërbimit” ose ekuivalentin e e saj,
- **ISO 27001: 2022** “Për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit” ose ekuivalentin e saj

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Referuar natyrës se veçantë, vendndodhjes dhe përmasave te objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët ekonomik, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë, menaxhimit dhe të sigurisë së informacionit.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë, menaxhimit dhe të sigurisë së informacionit janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia përgjegjëse ka hartuar termat e references, ne te cilat theksohet se janë shprehur qarte kërkesat AK për cilësinë e të gjithë shërbimit për realizimin e kontratës.

Po ashtu Njesia përgjegjëse thekson se në specifikimet teknike/termat e references nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT: